



Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

KEC

SHKËLZEN GASHI
DUKAGJIN PUPOVCI

KËNDVËSHTRIMI I PRINDËRVE PËR PJESËMARRJE NË JETËN E SHKOLLËS NË KOSOVË

Prishtinë, prill 2010

Këndvështrimi i prindërve për pjesëmarrje në jetën e shkollës në Kosovë

Kontakti:

Nora Tafarshiku
Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)
Kompleksi i Shkollës "Mileniumi i Tretë"
rr "Isa Kastrati", p.n.
Prishtinë
Tel/Fax. 038/244 258, lok. 109
E-mail: nora@kec-ks.org

Ky punim është realizuar në kuadër të projektit
"Avancimi i përfshirjes dhe cilësisë së arsimit në
Evropën Juglindore" me përkrahjen financiare të
Institutit për Shoqëri të Hapur – Budapest.

Të gjitha qëndrimet e shprehura në të janë të
autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk duhet t'i
atribuohen Institutit.



Për autorët

Shkëlzen Gashi ka mbaruar studimet për Shkenca Politike në Universitetin e Prishtinës. Në vitet 2006/2007 ka kryer studimet Master për të Drejta të Njeriut dhe Demokraci në Universitetin e Sarajevës dhe atë të Bolonjës. Ka punuar në disa OJQ për të drejtat e njeriut, ndër tjera edhe në Humanitarian Law Centre me seli në Beograd.

Dukagjin Pupovci është drejtor ekzekutiv i Qendrës për Arsim të Kosovës (KEC) dhe hulumtues shumëvjeçar në fushën e arsimit. Është doktor i shkencave të matematikës, mësimeve në universitet dhe pjesëmarrës aktiv në procesin e reformave të arsimit në Kosovë në të gjitha nivelet.

Falënderim

Autorët e këtij punimi dëshirojnë të shprehin mirënjohje të veçantë për:

- Z. Steve Powell nga proMENTE Research për këshilla të çmueshme të karakterit metodologjik dhe ndihmë të pakursyer në përpunimin dhe interpretimin e të dhënave.
- Z. Igor Repac nga Universiteti i Lubjanës për angazhim të vazhdueshëm në organizimin e aktiviteteve hulumtuese dhe koordinimin e komunikimit në mes të ekipit kosovar dhe ekipeve nga vendet tjera.
- Znj. Gordana Miljević nga Instituti për Shoqëri të Hapur në Budapest për inicimin e këtij projekti rajonal.

Shkurtesat

KEC	Qendra për Arsim e Kosovës
KPAK	Këshilli i Prindërve i Arsimit të Kosovës
MASHT	Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
OSI	Instituti për Shoqëri të Hapur
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara

Përmbajtja

Executive Summary	6
1. Prezantim	10
1.1 Hyrje	10
1.2 Metodologjia	12
2. Gjetjet.....	13
2.1 Një vështrim mbi variablat e përgjithshëm.....	13
2.2. Dimensionet e pjesëmarrjes	15
2.3 Faktorë parashikues dhe ndërmjetësues.....	23
2.4. Rezultatet e perceptuara të përfshirjes së prindërve	28
3. Përfundimet.....	30
4. Rekomandimet	34
Bibliografia	36

Executive Summary

The objective of this survey is to present parents' views on school-parent cooperation.

Methodology

The survey was carried out by means of direct interviews conducted by Ipsos Strategic Plus, following qualitative analysis of parental participation in Kosovo, and analysis of legal infrastructure.

The population of the study consisted of the following groups:

- A) Parents of primary-school children,
- B) Parents – members of school councils or parents' councils in the same schools as A,
- C) School principals,
- D) Socially excluded parents.

Sample size:

School sample: 32 schools in total

Sample A: 1,141 parents in total

Sample B: in each school, one School Council and four Parents' Council members were randomly selected for interviewing from among members of respective councils.

Sample P: Principals of each of 30 schools, plus 2 principals of 2 schools with socially excluded parents (32 principals in total),

Sample E: 2 samples of 30 socially excluded parents in 2 schools (60 socially excluded parents in total).

Table. Distribution of school sample according to geographic variable and urban/rural criterion

<i>Geographical Region</i>			Parental survey			Principals' Survey		
	<i>Schools</i>	<i>%</i>	<i>Sample</i>	<i>Urban</i>	<i>Rural</i>	<i>Sample</i>	<i>Urban</i>	<i>Rural</i>
Center	313	27.4	313	163	150	11	6	5
South-East	240	21.0	240	98	142	10	5	5
West	588	51.6	588	192	396	11	5	6
Total Kosovo	1141	100%	1141	453	688	32	16	16

For the purpose of this study the schools were randomly selected from among the those where principals participated in a previous survey on principals' views. The sample was stratified according to geographic regions (Center, South-East, West) and urban/rural

criterion. Selection was random and proportional to number of students in a schools. Principals were interviewed face-to-face.

On the other hand, the selection of parents was also random and based on school catchments area. Surveyors interviewed parents (mother or father, and, in particular cases, guardians) having at least one child aged 8-14 in a sampled school. Parent members of schools councils and parents' councils were selected randomly from lists submitted by school principals. All parents were interviewed face-to-face.

Main Findings

- It is obvious that socially excluded parents are disadvantaged in communication with the school. They are less frequently invited to attend parental meetings
- More than a half of average parents have never received any information on the way the child should be helped with homework, or any information on school regulations. It is interesting that the proportion of parents in urban areas having received this type of information is double of the proportion of parents in rural areas. Also, almost half of parents have not received any progress report during the previous academic year.
- In terms of their attitudes, most of the parents consider the school needs to ask them help their children with homework, even there is somebody in the family who can do that. Mothers are more involved in helping their children then fathers, and this proportion increases among socially excluded families.
- More than half of the parents (52%), mainly average parents and those involved in school structures, assert that during the previous academic year they were not invited to help with school activities. On the other hand, 75% of socially excluded parents were invited at least once to help with school activities. With regard to help with teaching, 100% of socially excluded parents confirmed they were not asked to provide it, just as vast majority of average parents.
- Almost half of the average parents were invited more than three times to help with school infrastructure improvement or maintenance, what is not the case with 92% of socially excluded parents. However, half of the parents from both categories confirm they they offered this type of help if they were asked to do so.
- Most of the parents were never asked for their opinion regarding financial management in the school, and this applies to all parents from socially excluded groups. In general, opinion of socially excluded parents on any matter related to school business was solicited only in isolated cases if any.
- Average parents very rarely (12-18%) tend to influence any school decision, either individually or in group with other parents. On the other hand, socially excluded parents do not even try to influence school decisions.
- Parents tend to be more open in expressing their opinion in one-to-one meetings with teachers as compared to parent meetings.

- All socially excluded parents confirmed that neither they nor their family members have ever been elected in school council or parents' council, although more than a half of them think they are capable of doing that.
- Most of socially excluded parents feel that teachers are unwilling to communicate with them. In general, parents think that teachers are too busy to communicate, and this percentage is higher in rural areas.
- 75% of Roma, Ashkali and Egyptian parents think that schools may do more to help their children.
- Most of the parents think that the school and parents should jointly make sure that children are happy at school and that they are making progress. However, vast majority of socially excluded parents claim that their children do not like going to school.

Recommendations

From the above conclusions recommendations are divided into three categories.

For schools:

1. Schools should develop procedures for meetings with parents, specifying the dynamics, preparation and content of such meetings. Group/thematic meetings should become a practice as well as individual meetings with parents. An action research undertaken in four Kosovo schools demonstrates that such procedures are prone to advance communication with parents. It is necessary to train teachers manage different types of meetings with parents and their use for advancing teaching and learning in school.
2. In addition to parents' meetings, schools should organize regular information using other media, like messages transmitted through students, e-mail, etc, particularly for cases requiring immediate parental attention.
3. Schools should engage in raising awareness of parents on their role in the school and should train them to exercise such a role. Also, parents should be aware that their role in relation to children is not exercised only by request from the school, but should be regularly exercised in the benefit of the children. A progress may be achieved if parental meetings are structured to convey mobilizing messages to parents.
4. Parents need a greater support from the school side in order to help the students in improve learning outcomes, because, even if they are willing to do that, they lack necessary knowledge and skills. By advancing communication with parents, schools should think of modalities for offering assistance to parents what can be achieved through information sessions.

For governmental sector:

1. Since Pre-University Education legislation change is in process, more attention should be paid to democratizing school governance, ensuring higher participation of parents in school life. On the other hand, more support needs to be provided to Kosovo Education Parental Council, re-established in 2009 after few years of inactivity.
2. To continue with financial decentralization to the school level by increasing responsibility of schools for managing their own finances and by creating additional possibilities for financial contributions of parents to schools.
3. To encourage schools improve communication with parents by supporting activities of professional, governmental and non-governmental, institutions in developing manuals and guidelines that help this process.

For non-governmental sector:

1. To work on raising awareness of parents on their role in the school and other levels. As a consequence, awareness raising activities should be organized in the school level as well as other levels such as: municipality, region and country.
2. To work on building the capacities of the parents' associations in all levels in order to help increase the influence of parents in school life. These associations should be trained to work with parents and their representatives in schools in building their capacity to better serve their role and responsibility.
3. To promote good practices of parental inclusion in the school life by creating opportunities to benefit from them.

1. Prezantim

1.1 Hyrje

Ky raport paraqet studimin e bërë në kuadër të projektit rajonal “Avancimi i përfshirjes dhe cilësisë në arsim në Evropën Juglindore” i mbështetur nga Programi për Mbështetjen e Arsimit në Institutin për Shoqëri të Hapur (Open Society Institute - OSI).

1.1.1 Disa fjalë për projektin “Avancimi i përfshirjes dhe cilësisë në arsim në Evropën Juglindore”

Përfaqësuesit e Institutit për Shoqërinë e Hapur dhe partnerëve të tij nga dhjetë vende të Europës Juglindore (Bosnjë dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Moldavia, Mali i Zi, Rumania, Serbia dhe Shqipëria), përmes një procesi me pjesëmarrje të gjerë, kanë identifikuar praninë e problemeve të ngjashme të cilat duhej të adresohen në rajon:

- Pabarazia në arsim, përkatësisht dallimi mes politikave dhe zbatimit të tyre, por edhe anashkalimi i formave të diskriminimit ndaj grupeve minoritare;
- Pjesëmarrje e pamjaftueshme e nxënësve dhe prindërve në sistemin arsimor, por edhe cilësia e dobët në arsim.

Për të adresuar këto shqetësime, projekti synon

(1) të kuptojë më mirë shkaqet e pabarazisë në arsim, duke bërë:

- sondazhet me drejtorët e shkollave për t'i nxjerrë në pah qëndrimet dhe praktikatat e tyre;
- sondazhet me prindër, për të kuptuar nevojat, pritjet dhe përvojat e tyre në përfshirjen e tyre në shkollë;

(2) të mbështesë iniciativa të qëndrueshme në nivel lokal, kombëtar dhe rajonal për të përmirësuar cilësinë dhe përfshirjen.

Faza e parë e projektit është realizuar në vitin 2008 duke rezultuar me një analizë gjithëpërfshirëse të qëndrimeve të drejtorëve të shkollave, për të vazhduar në vitin 2009 me kërkimin veprues (action research) të nismave në nivelin lokal që kanë për qëllim përmirësimin e pjesëmarrjes së prindërve në jetën e shkollës.

Në fazën e dytë të projektit, sondazhi i drejtorëve të shkollave është zgjeruar me sondazhin e prindërve, gjë që ka bërë të mundur të krahasohen rezultatet dhe të nxjerrën përfundime dhe rekomandime përkatëse për përmirësimin e gjendjes.

1.1.2 Konteksti ligjor i pjesëmarrjes në jetën e shkollës në Kosovë

Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, i hartuar nga i Dërguari i Posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për Statusin e Ardhshëm të Kosovës, Presidenti Martti Ahtisaari, është pjesë e Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës, të shpallur më 17 shkurt 2008, por edhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të aprovuar më 15 qershor 2008. Për më shumë, sipas nenit 143 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në rast se ka papajtueshmëri mes Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, ky i fundit mbizotëron. Përveç në Kushtetutën e Kosovës, Planit i Ahtisaarit është përfshirë edhe në legjislacionin kombëtar. Qeveria e Kosovës është në proces të shqyrtimit të legjislacionit për arsim në mënyrë që ta harmonizojë atë me Kushtetutën e Kosovës përkatësisht me Planin e Ahtisaarit.

Sidoqoftë, ligji në fuqi për Arsim në Komunitet e Republikës së Kosovës thotë që Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) ka përgjegjësi që të promovojë pjesëmarrjen e prindërve dhe komunitetit në aktivitetet arsimore dhe format e duhura të partneriteteve shkollë-komunitet në nivel lokal. Ndërkaq, Ligji nr. 2002/2 mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë, miratuar nga Kuvendi i Kosovës në tetor të vitit 2002, parasheh krijimin e Komitetit të Prindërve të Arsimit të Kosovës (KPAK), i përbërë nga nëntë anëtarë me mandat 4 vjeçar, për të përfaqësuar interesat e prindërve, për t'ia përcjellë MASHT-it mendimet e prindërve për çdo aspekt të arsimit fillor dhe të mesëm në Kosovë dhe për të qenë kanal kryesor i komunikimit midis MASHT-it dhe prindërve.

Duhet thënë se procedurën e zgjedhjes dhe përgjegjësitë e organeve qeverisëse, profesionale dhe personelit tjetër të shkollave fillore dhe të mesme në territorin e Kosovës i përcakton Udhëzimi Administrativ i MASHT-it, i miratuar më 28 janar 2003. Sipas këtij udhëzimi, çdo shkollë në Kosovë duhet të formojë Këshillin e Shkollës, i cili zgjedhet nga mësimdhënësit e shkollës dhe përfaqësuesit e prindërve. Në Këshillin e Shkollës mësimdhënësit kanë të drejtë të zgjedhin pesë përfaqësues, kurse prindërit kanë të drejtë të zgjedhin tre përfaqësues, ndërsa Këshilli i Nxënësve të Shkollës ka të drejtë të zgjedhë një përfaqësues nga radhët e nxënësve. Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit të Shkollës bëhet në mënyrë të fshehtë dhe mandati i tyre është tre vjet, me mundësi rizgjedhjeje me kusht që ata vazhdojnë të jenë prindër të nxënësve, mësues ose nxënës të shkollës.

Kryetari i Këshillit të Shkollës zgjedhet çdo vit me vota të fshehta dhe duhet të jetë nga radhët e prindërve, kurse Sekretar i Këshillit të Shkollës është Drejtori i Shkollës, i cili nuk ka të drejtë vote. Këshilli i Shkollës ka përgjegjësi: për hartimin e rregullave të shkollës, të cilat i paraqiten për miratim komunës; për të zgjedhë një përfaqësues të prindërve dhe një përfaqësues të profesorëve për të marrë pjesë në zgjedhjen e drejtorit të shkollës dhe profesorëve; për të vendosë për caktimin e fondeve me kontribut nga prindërit dhe fondet tjera të siguruar jashtë buxhetit të shkollës; për veprimtaritë jashtë shkollë; për mbajtjen e dokumentacionit për të gjitha mjetet financiare të shkollës. Këshilli i Shkollës konsultohet për çështjet e zhvillimit fizik të shkollës, çështjet e programit shtesë mësimor (por jo për programin mësimor sepse kjo është kompetencë e Ministrisë së Arsimit), datat e pushimeve të shkollës dhe përgjithësisht shprehjen e pikëpamjeve të tyre lidhur me shkollën.

1.2 Metodologjia

Për këtë studim hulumtimi është bërë përmes metodës së sondazhit përkatësisht intervistave të drejtpërdrejta, të cilat janë kryer nga Ipsos Strategic Puls, duke u shqyrtuar paraprakisht pjesëmarrja e prindërve në Kosovë, por edhe legjislacioni përkatës.

1.2.1 Objektivat e studimit

Ky studim ka për qëllim vënien në pah të qëndrimeve të prindërve për bashkëpunimin prindër-shkollë.

1.2.2 Mostra

Popullacioni i studimit përbëhej nga :

- E) Prindër të nxënësve të shkollës fillore,
- F) Prindër anëtarë të këshillave të shkollës ose të këshillave të prindërve në të njëjtën shkollë,
- G) Drejtorë shkollash në secilën shkollë,
- E) Prindër të përjashtuar në aspektin social.

Madhësia e mostrës:

Mostra e shkollave: 32 shkolla gjithsej

Mostra A: 1,141 prindër gjithsej

Mostra B: në çdo shkollë, një anëtar i këshillit të shkollës dhe katër anëtarë të Këshillit të Prindërve u përzgjedhën për intervistë në mënyrë rastësore nga një listë e anëtarëve të Këshillit në përfundim të vitit të fundit shkollor.

Mostra P: drejtorët e secilës nga 30 shkollat e vendit, plus 2 drejtorët nga 2 shkollat me prindër të përjashtuar nga ana sociale (32 drejtorë në të gjithë vendin)

Mostra E: 2 mostra me 30 prindër të përjashtuar nga ana sociale në 2 shkolla (gjithsej 60 prindër të përjashtuar nga ana sociale)

Tabela 1. Shpërndarja e mostrës së shkollave sipas variablit të rajonit gjeografik dhe përkatësisë urbane/rurale

<i>Rajonet gjeografike</i>			Sondazhi me prindërit			Sondazhi me drejtorët e shkollave		
	<i>Shkollat</i>	<i>%</i>	<i>Mostra</i>	<i>Urban</i>	<i>Rural</i>	<i>Mostra</i>	<i>Urban</i>	<i>Rural</i>
Qendër	313	27.4	313	163	150	11	6	5
Jug-lindje	240	21.0	240	98	142	10	5	5
Perëndim	588	51.6	588	192	396	11	5	6
Total Kosovë	1141	100%	1141	453	688	32	16	16

Për këtë studim është marrë lista e shkollave drejtorët e të cilave kanë marrë pjesë në sondazhin paraparak, kurse lloji i mostrës ka qenë i rastësishëm dhe i stratifikuar, e stratifikimi është bërë sipas rajoneve gjeografike (qendër, juglindje dhe perëndim) dhe sipas përkatësisë urban/rural. Selektimi ka qenë rastësor dhe në proporcion me numrin e nxënësve në shkollë. Selektimi i drejtorëve të shkollave është bërë duke kontaktuar drejtorët e secilës shkollë të përzgjedhur dhe duke realizuar intervistën drejtpërdrejt.

Ndërsa selektimi i prindërve është bërë rastësor, por duke pas për bazë zonën që ka mbuluar shkolla e selektuar. Anketuesit kanë anketuar prindër (nënë ose babain, e në raste të veçanta kujdestarët kryesorë të familjes) që kanë pas një fëmijë që vijon mësimin në shkollat në mostër dhe që i takon moshës mes 8-14 vjeç. Intervistat janë realizuar drejtpërdrejt duke e pas për bazë pyetësin. Kurse intervistat me prindërit e shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara janë bërë duke përfshirë edhe një person nga ky grup. Ndërsa përzgjedhja e prindërve që ishin anëtarë të këshillave apo këshillave të prindërve është bërë duke siguruar nga shkollat listat e këtyre prindërve dhe edhe këtu intervistat janë bërë drejtpërdrejt.

Në këtë raport janë analizuar të dhënat nga gjetjet e mostrave të prindërve dhe të drejtorëve të shkollave. Pra, janë marrë për bazë të dhënat e prindërve, por edhe të dhënat e drejtorëve të shkollave ku ndjekin mësimin fëmijët e prindërve të intervistuar. Meqenëse se qëllimi i sondazhit ka qenë fokusimi te prindërit, rezultatet e prezantuara më poshtë u janë referuar kryesisht prindërve. Duhet thënë se në raport paraqiten gjetjet që janë statistikisht të rëndësishme.

2. Gjetjet

2.1 Një vështrim mbi variablat e përgjithshëm

Gjysma e prindërve pohojnë se fëmijët e tyre pëlqejnë të shkojnë në shkollë, kurse pak më pak se gjysma (45%) thonë se fëmijët e tyre e kanë shumë qejf shkuarjen në shkollë dhe kjo është pak a shumë e njëjtë si në vendet rurale ashtu edhe në ato urbane. Shumica dërmuese (73%) e prindërve të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara pohojnë se fëmijëve të tyre nuk u pëlqen vajtja në shkollë.

Prindërit e zakonshëm (40%) dhe prindërit përfaqësues në strukturat shkollore (58%) i vlerësojnë si të shkëlqyeshme arritjet e përgjithshme të fëmijës së tyre në shkollë, ndërsa gati gjysma e prindërve të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara e vlerësojnë si të dobët dhe nënmesatare arritjen e përgjithshme të fëmijës së tyre në shkollë.

Në pyetjen se a kanë fëmijët e tyre vështirësi në shkollë, 84% e prindërve kanë deklaruar se nuk kanë vështirësi, ndërsa 12% e prindërve të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara kanë deklaruar se fëmijët e tyre kanë kryesisht probleme në sjellje, kurse 67% e këtyre prindërve kanë deklaruar se fëmijët e tyre kanë vështirësi në marrëdhënie me bashkëmoshatarët. Gati të gjithë prindërit (97%) kanë deklaruar se

fëmijët e tyre nuk kanë nevojë për vëmendje të veçantë në shkollë për shkak të ndonjë nevoje speciale.

¼ e prindërve të intervistuar kanë thënë se në shtëpitë e tyre kanë 1-10 libra; 31% e prindërve të intervistuar kanë thënë se në shtëpitë e tyre kanë 11-50 libra; 23% e prindërve të intervistuar kanë thënë se në shtëpitë e tyre kanë 51-100 libra. Gati gjysma (47.1%) e prindërve të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara kanë deklaruar se në shtëpitë e tyre kanë 1-10 libra.

Shumica e prindërve të intervistuar (67%) kanë deklaruar se posedojnë kompjuter në shtëpitë e tyre, por, në anën tjetër, po aq është përqindja e prindërve të anketuar të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara që nuk kanë kompjuter në shtëpi. Pak më shumë se gjysma e prindërve të intervistuar (53%) kanë deklaruar se kanë internet në shtëpitë e tyre, por, në anën tjetër, 88% e prindërve të anketuar të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara nuk kanë internet në shtëpi. Përqindja më e madhe e prindërve që kanë në shtëpitë e tyre kompjuter (82%) dhe internet (72%) janë prindër përfaqësues në strukturat shkollore. Më pak se gjysma e prindërve të anketuar (41%) pohojnë se secili fëmijë i tyre që shkon në shkollë ka tavolinën e shkrimit në shtëpi, ndërsa të gjithë prindërit e anketuar të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara kanë thënë se fëmijët e tyre nuk kanë tavolinë shkrimi në shtëpi.

Gjysma e prindërve të intervistuar (51%) janë nënat, kurse 45% e të intervistuarve janë baballarët, ndërsa të anketuarit e shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara, 82% e të anketuarve janë baballarët. Po ashtu, është me rëndësi të thuhet se më pak se gjysma e nënave të intervistuar (44%) kanë shkollim të mesëm, ndërsa të intervistuarit e shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuar 84% janë vetëm me shkollë fillore. Dallimi mes zonave rurale dhe urbane është shumë i lehtë. Shumica e nënave të intervistuar (74%) nuk kanë ndjekur kurse për të rritur, ndërsa asnjëra prej nënave të intervistuar të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara nuk kanë marrë pjesë në kurse për të rritur.

Derisa gjysma e nënave të intervistuar thonë se do të ishin përfundimisht apo ndoshta do të ishin të interesuara për të marrë pjesë në trajnime, të nënat e intervistuar të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara, 77% përfundimisht nuk janë të interesuara dhe 15% ndoshta jo. Shumica dërmuese e nënave të anketuar (80%) thonë se planet e familjes janë që ta dërgojnë fëmijën e tyre deri në shkollimin e lartë, ndërsa në anën tjetër, 84.3% e nënave të intervistuar të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara, pohojnë se shkolla fillore është e mjaftueshme.

Gati të gjithë prindërit e anketuar kanë ujë të ftohtë, të ngrohtë dhe dush në shtëpitë e tyre, ndërsa të prindërit e shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara gati të gjithë – edhe pse kanë ujë të ftohtë e të ngrohtë – nuk kanë dush. Gati të gjithë kanë banjo brenda shtëpisë, shporet për gatim, frigorifer dhe larëse rrobash, por këtë të fundit nuk e kanë 76% e prindërve të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara. Shumica e prindërve (67%) kanë pohuar se kanë makinë larëse për enë, e në anën tjetër asnjëri prej prindërve të anketuar të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara nuk ka makinë larëse për enë.

2.2. Dimensionet e pjesëmarrjes

2.2.1 Takimet me prindër në shkollë

Prindërit thonë se shkolla ka ftuar në mbledhje 43% të tyre dy deri tri herë, kurse 33% të tyre janë ftuar më shumë se tri herë, ndërsa te prindërit e shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara, 76% e tyre janë ftuar vetëm një herë. Prindërit janë të mendimit se shkolla duhet t'i ftojë ata në mbledhje të prindërve. Më pak se gjysma e prindërve të intervistuar (42%) pohojnë se janë ftuar dy deri në tre herë në takime individuale për të biseduar mbi shkollimin e fëmijës së tyre, ndërsa 76% e prindërve të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara thonë se në takime të tilla janë ftuar vetëm një herë. Shumica dërmuese e prindërve thonë se shkolla duhet t'i ftojë prindërit në këto takime. Prindërit (69%) pohojnë se të paktën dikush në familjen e tyre është i aftë dhe kompetent për të shfrytëzuar për të mirë mbledhjet me prindër, por edhe ka për detyrim ta bëjë një gjë të tillë. Edhe më e madhe është përqindja (82%) e prindërve që pohojnë se pjesëmarrja e tyre në këto takime ndihmon fëmijën e tyre.

2.2.2 Informacione në formë të shkruar për prindërit

Në vitin e kaluar 35% të prindërve të zakonshëm shkolla u ka dërguar dy deri tri herë në vit informacion në formë të shkruar për mbarëvajtjen e fëmijës (vlerësim të shkruar, listë notash, raporte finale dhe/ose raporte të ngjashme), ndërsa 26% e prindërve të zakonshëm kanë marrë informacione të tilla më shumë se tri herë, kurse 35% nuk kanë marrë kurrë informacione të tilla. Shumica e drejtorëve kanë konfirmuar se shkolla është e obliguar t'u dërgojë prindërve informacione të tilla.

Më shumë se gjysma e prindërve kanë pohuar se shkolla nuk u ka dërguar asnjëherë informacion të shkruar mbi mënyrën se si të ndihmojnë fëmijën të mësojë për shkollën, për rregullat, dhe për mbajtjen e mësimëve. Ata që e kanë marrë këtë informacion, kanë deklaruar se në të shumtën e herave raporti është lexuar nga dikush prej familjarëve dhe shumica e tyre kanë deklaruar se shkolla është e obliguar që të dërgojë raporte të tilla. Sipas rezultateve del se prindërit meshkuj janë më të prirë për t'i lexuar këto informacione. Shumica e drejtorëve pranojnë se shkolla është e obliguar që t'u dërgojë prindërve informacionet e lartpërmendura. Numri i prindërve të zakonshëm që pranojnë letra të këtilla është dyfish më i lartë në zonat urbane.

Shumica e prindërve të zakonshëm dhe atyre të përfshirë në struktura shkollore thonë se shkolla gjatë vitit të kaluar nuk u ka dërguar asnjëherë informacione të shkruara për çështje si shëndeti, droga, dhuna... Ato familje që e kanë pranuar këtë lloj raporti thonë se ai është lexuar nga ndonjëri prej familjarëve dhe shumica dërmuese e tyre pranojnë se shkolla është e detyruar ta dërgojë këtë lloj informacioni. Edhe kur një gjë e tillë ndodhë, informacionet u dërgohen më shumë prindërve të përfshirë në struktura të shkollës, kurse mosdërgimi i informacioneve të tilla më së shumti ndodhë në jug të vendit. Përkritazi me çështjet e lartpërmendura, 68% e prindërve të anketuar pohojnë se të paktën njëri nga familjarët është kompetent për të lexuar këto materiale dhe pothuajse po aq është përqindja e prindërve që deklarojnë se dikush prej familjes e ka për detyrim t'i lexojë këto materiale dhe se leximi i këtyre materialeve ndihmon fëmijën e tyre.

Në pyetjen se sa herë shkolla u ka dërguar prindërve informacione të shkruara për mbarëvajtjen e fëmijës – vlerësim i shkruar, raporte notash, raporte përfundimtare, dhe/ose raporte të ngjashme, pavarësisht nëse janë dhënë në ndonjë takim klase, janë dërguar me anë të fëmijës, janë dërguar në shtëpi, apo në një mënyrë tjetër të ngjashme, 43% e prindërve thonë se nuk kanë marrë asnjëherë informacione të këtilla gjatë të vitit të kaluar, kurse 26% një herë, ndërsa 24% dy deri në tre herë dhe këto raporte të shumtën e herave janë lexuar nga dikush në shtëpi. Shumica thonë se shkolla duhet t'ua dërgojë prindërve raportet e këtilla.

Më shumë se gjysma e prindërve, kryesisht prindër të zakonshëm dhe të përfaqësuar në strukturat e shkollës, kanë pohuar se shkolla gjatë vitit të kaluar nuk u ka dërguar kurrë letër informative. Prindërit që kanë pranuar letra të këtilla, thonë se të shumtën e herave ato janë lexuar nga ndonjëri prej familjarëve. Po ashtu, ata pohojnë se dërgimi i raporteve të tilla është obligim i shkollës.

2.2.3 Përkrahja për të mësuar

Shumica e prindërve pohojnë se është detyrë e shkollës që t'ua kërkojnë familjeve që t'i ndihmojnë fëmijët në detyrat e shtëpisë dhe sipas tyre të paktën dikush nga familja është i aftë dhe kompetent për ta bërë këtë gjë, por edhe është detyrë e familjes që t'u ndihmojë fëmijëve të tyre. Ata pohojnë se kjo ndihmon fëmijët e tyre. Të pyetur se sa kohë shpenzon fëmija i tyre në ditë për të bërë detyrat, 27% e prindërve janë përgjegjës se fëmijëve u duhet 60-90 minuta për të bërë detyrat, ndërsa 26% e tyre 90-120 minuta, ndërsa 80% e prindërve të anketuar të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara thonë se fëmijëve të tyre u duhet më pak se 30 minuta për të bërë detyrat e shtëpisë.

Në shumicën e rasteve fëmijët ndihmohen nga nëna rreth kryerjes së detyrave të shtëpisë, kurse prindërit e të anketuarve të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara, në të gjitha rastet ndihmohen nga nënat. Këtu më shumë janë të përfshirë prindërit që janë pjesë e strukturave të shkollës. Shumica e drejtorëve të shkollave thonë se shkolla nuk i ka furnizuar prindërit me udhëzime se si të ndihmojnë në mënyrë efektive fëmijët në lidhje me detyrat e shtëpisë, por sipas tyre, prindërit nuk e kanë kërkuar një gjë të tillë.

Pak më shumë se gjysma e prindërve (52%), kryesisht prindër të zakonshëm dhe prindër të përfshirë në strukturat e shkollës, pohojnë se gjatë vitit të kaluar, shkolla asnjëherë nuk i ka ftuar për të ofruar ndihmë me aktivitete sportive, sociale dhe kulturore – teatër, koncerte, ekskursionet, etj., ndërsa 75% e prindërve të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara thonë se një gjë e tillë u është kërkuar të paktën një herë nga ana e shkollës. Prindërit që kanë marrë këtë lloj ftese nga ana e shkollës kanë dhënë të paktën një herë ndihmën e tyre për këtë çështje. Pak më shumë se gjysma kanë thënë se shkolla duhet ta kërkojë një gjë të tillë nga prindërit.

Shumica dërrmuese e prindërve dhe të gjithë prindërit e shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara, kanë pohuar se gjatë vitit të kaluar shkolla asnjëherë nuk u ka kërkuar ndihmë me orët mësimore – tregimi i një historie, biseda mbi punën, luajtje e një instrumenti, asistencë për mësimdhënësit. Kjo është dukshëm më e theksuar në

zonat rurale (88%). Gjysma e atyre që e kanë marrë këtë lloj ftese kanë ofruar ndihmën e tyre çdo herë dhe kjo është shumë më e theksuar në zonat urbane. Po ashtu, gjysma kanë thënë se shkolla duhet ta kërkojë një gjë të tillë nga prindërit.

Më shumë se gjysma (68%) e familjeve të zakonshme (përqindja në zonat rurale është dukshëm më e lartë) nuk janë ftuar asnjëherë që të ofrojnë ndihmën e tyre në shërbimet shkollore si biblioteka, vendi i lojërave dhe dhoma e ngrënies dhe po aq është përqindja e atyre që janë të mendimit se shkolla duhet ta kërkojë një gjë të tillë. Më pak se gjysma (43%) e atyre që u është kërkuar një ndihmë e tillë, kanë dhënë ndihmën e tyre të paktën një herë dhe, sipas tyre, shkolla duhet t'ua kërkojë prindërve një gjë të tillë. Më shumë se gjysma e prindërve (58%) kanë pohuar se në familjet e tyre të paktën një person është i aftë dhe kompetent për të ndihmuar në ndonjë mënyrë rreth ndihmave vullnetare të përmendura më lart dhe pak më pak se gjysma e tyre (48%) mendojnë se të paktën dikush prej familjes e ka për detyrim që të ofrojë këtë ndihmë. Sipas tyre me dhënien e kësaj ndihme vullnetare për shkollën ndihmohen edhe fëmijët e tyre.

2.2.4 Ndhma vullnetare

Gati gjysma e prindërve të zakonshëm kanë qenë të ftuar 3 ose më shumë se 3 herë nga shkolla për të ndihmuar në mirëmbajtjen ose përmirësimin e infrastrukturës së shkollës si pastrimin, lysterjen, ndërtimin, etj. Mbi gjysma e tyre kanë dhënë këtë ndihmë çdo herë ose të shumtën e herave dhe kjo përqindje është dyfish më e madhe në zonat urbane.

Pak më shumë se gjysma e prindërve kanë thënë se shkolla nuk i ka ftuar kurrë për të dhënë ndihmë në mirëmbajtjen ose përmirësimin e infrastrukturës shkollore si pastrimi, ndërtimi, lysterja, ndërsa 92% e prindërve të anketuar të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara, pohojnë se shkolla nuk i ka ftuar ndonjëherë për ta dhënë këtë ndihmë. Gati gjysma kanë thënë se e kanë dhënë këtë ndihmë çdo herë dhe gati gjysma kanë thënë se e kanë dhënë këtë ndihmë një herë dhe se shkolla duhet ta kërkojë një gjë të tillë. Shumica e dërmuese e drejtorëve mendojnë se shkolla duhet t'ua kërkojë prindërve të zakonshëm një ndihmë të tillë.

Pothuajse gjysma e prindërve të zakonshëm nuk kanë qenë të ftuar asnjëherë nga shkolla për të ndihmuar me aktivitete sportive, sociale dhe kulturore – teatër, koncerte, ekskursionet, etj. Në zonat rurale 62% e prindërve të zakonshëm nuk kanë qenë të ftuar asnjëherë nga shkolla për të ndihmuar me aktivitete të tilla. Shumica e drejtorëve është e mendimit se shkolla duhet t'i ftojë familjet në këto aktivitete.

2.2.5 Pjesëmarrja në vendimmarrje

Shumica e prindërve të zakonshëm kanë thënë se gjatë vitit të kaluar nuk u është kërkuar mendim për menaxhimin financiar të shkollës: si shpenzohet paraja në shkollë – ndërtimet, pajisjet, materialet, etj, ani se sipas më shumë së gjysmës së drejtorëve, shkolla duhet ta kërkojë një gjë të tillë nga prindërit. Gati gjysma e prindërve që u është kërkuar mendimi për këto çështje pohojnë se e kanë ndihmuar shkollën çdo herë, por, sipas tyre, në vetëm 31% të rasteve kërkesat e tyre janë marrë parasysh nga shkolla.

Tabela 2. Kërkimi i mendimit nga prindërit për menaxhim financiar

Sa herë ka kërkuar shkolla mendimin tuaj në vitin e kaluar (PERSONALISHT APO FAMILJARISHT)?	1. Kurrë	2. Një herë	3. 2-3 herë	4. më shumë se 3 herë
Mostra A (prindërit e zakonshëm)	80%	12%	6%	2%
Mostra B (prindërit e përfaqësuar)	58%	18%	22%	3%
Mostra E (prindërit e përjashtuar)	100%	0%	0%	0%

Po ashtu, gati gjysma e drejtorëve thonë se prindërve të zakonshëm nuk u është kërkuar asnjëherë mendim mbi aktivitete shtesë shkollore (sport shtesë, gjuhë të huaja, arte, etj.), ndërsa më shumë se gjysma e drejtorëve kanë pohuar se këtë shkolla duhet t'ua kërkojë prindërve/familjarëve. Shumica dërrmuese e prindërve dhe të gjithë prindërit e shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara kanë pohuar se gjatë të vitit të kaluar shkolla asnjëherë nuk ka kërkuar mendimin e tyre për aktivitete shtesë shkollore (sporte shtese, arte, gjuhë të huaja etj.). Gjysma e tyre thonë se ja kanë dhënë mendimin e tyre e shkollës çdo herë dhe sipas tyre shkolla duhet t'u kërkojë prindërve mendimin e tyre për këtë çështje.

Gjysma e drejtorëve kanë pohuar se gjatë vitit të kaluar shkollor shkolla u ka kërkuar 2 deri 3 herë mendim prindërve të zakonshëm përkritazi me organizimin e ngjarjeve shkollore (festime ekskursione, etj.) dhe sipas tyre, gati gjysma e prindërve ka dhënë mendim për këtë çështje çdo herë, të tjerët shumicën e herave dhe ndonjë herë. Shkolla këto mendime i ka marrë parasysh ose tërësisht ose në një masë të madhe dhe shumica e drejtorëve mendon se shkolla duhet ta kërkojë një gjë të tillë nga prindërit.

Në anën tjetër, 38% e prindërve kanë pohuar se shkolla gjatë vitit të kaluar u ka kërkuar vetëm një herë mendim lidhur me organizimin e ngjarjeve shkollore (festime, ekskursione, etj.), 25% u është kërkuar mendimi 2 deri në 3 herë, ndërsa 32% e tyre thonë se shkolla nuk u ka kërkuar asnjëherë mendim për këtë çështje, e në zonat rurale kjo përqindje është dyfish më e lartë. Gati gjysma e prindërve (46%) kanë thënë se çdo herë i kanë dhënë mendim shkollës, kurse 35% vetëm një herë, ndërsa 35% kanë thënë se shkolla e ka marrë parasysh mendimin e tyre tërësisht, 32% kanë thënë në masë të madhe, kurse të gjithë prindërit e shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara, thonë se shkolla i ka marrë parasysh mendimet e tyre paksa. Më shumë se gjysma e tyre (56%) kanë thënë se është detyrë e shkollës të kërkojë mendimin prindërve.

Vetëm 13 % e drejtorëve thonë se prindërve të zakonshëm gjatë vitit të kaluar shkollor nuk u është kërkuar asnjëherë mendim për shëndetin dhe çështjet e sigurisë (rojet mbikëqyrëse, kalimi i rrugës, kamerat, droga, raporti me policinë, etj.) dhe sipas tyre shumica dërrmuese e prindërve të zakonshëm e kanë dhënë mendimin e tyre për çështjen e sipërpërmendur çdo herë ose shumicën e herave dhe këto mendime janë marrë parasysh tërësisht ose në një masë të gjerë. Shumica dërrmuese e drejtorëve (76%) pohojnë se shkolla është përgjegjës për t'ua kërkuar prindërve një gjë të tillë.

Më shumë se gjysma e prindërve të zakonshëm, por edhe të përfshirë në strukturën shkollore, thonë se nuk u është kërkuar asnjëherë mendim për çështjet e përmendura më lart, kurse 96% e prindërve të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara kanë thënë se shkolla nuk u ka kërkuar mendim për këto çështje. Po ashtu,


në zonat rurale, kjo gjë është dukshëm më e theksuar (68%) se sa në ato urbane (42%). Pothuajse gjysma e prindërve që kanë pranuar një kërkesë të tillë nga shkolla, thonë se kanë ofruar ndihmën e tyre çdo herë, e ata thonë se në të shumtën e herave (69%) shkolla ka marrë parasysh në një masë të madhe ose tërësisht mendimet e tyre, kurse gjysma e prindërve kanë thënë se shkolla e ka për detyrë t'ua kërkojë mendimin për këto çështje.

Pak më shumë se gjysma e drejtorëve (55%) pohojnë se gjatë vitit të kaluar shkollor, shkolla asnjëherë nuk ka kërkuar marrjen e mendimit të familjeve lidhur me menaxhimin e përgjithshëm të shkollës – turnet, oraret e hapjes, shkrija ose mbyllja e hapja në shkollë, ndryshimi i vendndodhjes, ndryshimi i llojit të shkollës, etj. Sipas tyre shkolla duhet t'ua kërkojë prindërve mendimin për një gjë të tillë. Shumica dërmuese e prindërve (75%), kryesisht prindër të zakonshëm, por edhe të përfshirë në strukturat shkollore, kanë deklaruar se gjatë vitit të kaluar shkolla asnjëherë nuk i ka pyetur për çështjet e përmendura në këtë paragraf. Prej tyre, 100% e prindërve të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara kanë thënë se shkolla nuk i ka pyetur kurrë për çështjet e sipërpërmendura. Kjo shifër në zonat rurale është dukshëm më e lartë se sa në ato urbane. Pothuajse të gjithë ata që e kanë pranuar një ftesë të tillë thonë se të paktën një herë, shumicën e herave ose çdo herë i kanë ofruar këtë lloj mendimi shkollës. Prindërit kanë deklaruar se shkolla ka marrë parasysh tërësisht (43%), në një masë të gjerë (27%) apo paksa (25%) mendimet e tyre. Më pak se gjysma e prindërve (46%) të anketuar mendojnë se kjo është një gjë që shkolla duhet t'ua kërkojë, kurse pjesë tjetër kryesisht thonë se ndoshta shkolla duhet t'ua kërkojë një gjë të tillë.

Gjatë vitit të kaluar shkollor, sipas drejtorëve, shkolla i ka kërkuar tre ose më shumë se tre herë gati gjysmës së prindërve të zakonshëm mendimin lidhur me çështjet arsimore – përmbajtja e mësimi, tekstet mësimore, përzgjedhja ose vlerësimi i mësimdhënësve, ngarkesa mësimore e nxënësit, detyrat e shtëpisë, etj. Mendim për një gjë të tillë kanë kërkuar shumë më shumë shkollat në zonat urbane. Më shumë se gjysma e shkollave kanë marrë parasysh mendimet e prindërve të zakonshëm tërësisht ose në një masë të gjerë dhe sipas tyre shkolla është përgjegjëse për t'ua kërkuar prindërve mendimet për këto çështje.

Mirëpo, shumica e prindërve (65%) kanë thënë se gjatë vitit të kaluar shkolla asnjëherë nuk u ka kërkuar mendim për çështjet arsimore – përmbajtja e leksioneve, tekstet mësimore, përzgjedhja ose vlerësimi i mësimdhënësve, ngarkesa mësimore e nxënësit dhe detyrat e shtëpisë. Ndërsa të gjithë prindërit e shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara kanë thënë se shkolla nuk u ka kërkuar asnjëherë mendim për çështjet e lartpërmendura. Shumica dërmuese (81%) e prindërve në zonat rurale kanë deklaruar se shkolla nuk i ka pyetur kurrë për çështjet e përmendura më sipër, ndërsa në zonat urbane më pak se gjysma (43%) kanë thënë se shkolla nuk i ka pyetur kurrë për këto çështje. Vetëm 3% e prindërve të anketuar nuk e kanë dhënë mendimin e tyre asnjëherë për këto çështje, ndërsa 31% kanë deklaruar se shkolla ka marrë parasysh mendimet e tyre. Gjysma kanë thënë se shkolla duhet t'ua kërkojë mendim për këto çështje, kurse pjesa tjetër ka thënë se ndoshta.

Grafiku 1. Në lidhje me mbledhjet me prindërit, (takime klase, në grup apo individuale), a ndihet të paktën njëri në familjen tuaj i aftë dhe kompetent për të shfrytëzuar për mirë këtë lloj takimi?



Shumica e drejtorëve (72%) pohojnë se gjatë vitit të kaluar prindërve të zakonshëm u është kërkuar tri ose më shumë herë që të japin mendim lidhur me dhunën ndaj nxënësit, përjashtimet dhe çështjet procedurale që kanë të bëjnë me nxënësit dhe sipas tyre shumica dërrmuese e prindërve u është përgjegjur çdo herë ose të shumtën e herave kërkesës së shkollës për të dhënë mendim lidhur me çështjet e përmendura më lart dhe këto mendime, sipas gati gjysmës së drejtorëve (48%), janë marrë parasysh nga ana e shkollës tërësisht. Më pak se gjysma e prindërve (41%), shumica e tyre prindër të zakonshëm, kanë pohuar se gjatë vitit të kaluar, shkolla nuk u ka kërkuar asnjëherë mendim për dhunën ndaj nxënësit, përjashtimet dhe çështje e procedura të tjera që kanë të bëjnë me disiplinën e nxënësit. Kjo përqindje është dukshëm më e thellë në zonat rurale (49%) sesa në ato urbane (30%). Diku 42% e prindërve që kanë marrë ftesë nga shkolla për të dhënë mendim për këtë çështje thonë se kanë ofruar mendim pothuajse çdo herë, kurse 61% e prindërve kanë deklaruar se shkolla ka marrë në një masë të madhe apo tërësisht parasysh mendimet e tyre, ndërsa 55% e tyre thonë se shkolla është e obliguar t'u kërkojë atyre një gjë të tillë.


Gjysma e prindërve të zakonshëm, sipas drejtorëve, është munduar 2-3 herë ose më shumë se 3 herë që të ndikojë në mënyrë individuale (pa iu kërkuar nga shkolla) për ndonjë notë apo ankesë për ndonjë fëmijë tjetër dhe kjo është realizuar në më shumë se gjysmën e rasteve. Mirëpo, shumica dërrmuese e prindërve (82 %) thonë se asnjëherë nuk janë munduar të ndikojnë vetë për të bërë ankesa për një notë, ankesa për ndonjë fëmijë tjetër, etj., ndërsa 100% e prindërve të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara kanë thënë se nuk janë munduar ndonjëherë të ndikojnë personalisht për të bërë ankesat e mësipërme.

Më shumë se gjysma e drejtorëve (55%) pohojnë se prindërit e zakonshëm asnjëherë nuk janë përpjekur që të ndikojnë në diçka së bashku me prindërit e tjerë (në raste kur nuk u është kërkuar nga shkolla). Shumica dërrmuese e prindërve (88%) thonë se nuk janë munduar asnjëherë të ndikojnë në diçka së bashku me prindërit e tjerë, ndërsa prindërit e shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara, kanë thënë se nuk janë munduar asnjëherë për ta bërë një gjë të tillë.

Sipas gjetjeve rezulton se 61% e prindërve të zakonshëm japin mendimet/qëndrimet e tyre nëpërmjet takimeve individuale të prindërve me mësuesin/pedagogun/drejtorin e shkollës. Ndërsa, përqindja e prindërve që japin mendimet/qëndrimet e tyre në

mbledhje të klasës ose përmes përfaqësuesve në organizmat e shkollës është dukshëm më e vogël. Shumica e drejtorëve (56%) pohojnë se prindërit janë ndarë të kënaqur me mënyrën se si shkolla ka vepruar mbi mendimet/iniciativat e tyre. Shumica e prindërve (60%) mendojnë se janë të aftë dhe kompetentë për të dhënë kontributin e tyre në ndonjërin nga mënyrat e sipërpërmendura, madje ata mendojnë se kjo është një detyrë e tyre dhe se kontributi i tyre në vendim-marrje mund të ndihmojë fëmijën e tyre.

Grafiku 2. A u munduat të ndikoni diçka bashkë me prindër të tjerë (pa ua kërkuar shkolla)?



2.2.6 Roli i prindërve në shkollë

Prindërit (84%), prej të cilëve 100% e prindërve të anketuar të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara, kanë deklaruar se gjatë tri viteve të kaluara askush nga familjet e tyre nuk e ka mbajtur postin e përfaqësuesit të prindërve. Po ashtu, 86.3%, në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara 100%, kanë deklaruar se gjatë tre viteve të kaluara, asnjëherë nuk e kanë mbajtur postin e anëtarit të Këshillit të Shkollës apo në ndonjë organizim tjetër të ngjashëm. Më shumë se gjysma kanë deklaruar se ata apo dikush nga familja janë të aftë për të mbajtur pozita në këto organizime. Më shumë se gjysma mendojnë se kjo do të ndihmonte fëmijët e tyre.

2.2.7 Bashkëpunimi shkollë-komunitet

Afërsisht 1/3 e prindërve janë shprehur se deri në njëfarë mase prindërit nuk janë të interesuar për pjesëmarrje në aktivitete shkollore dhe po aq kanë thënë se prindërit nuk janë të interesuar aspak. Shumica dërrmuese e prindërve që u takojnë shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara kanë thënë se janë deri në njëfarë mase të interesuar për të marrë pjesë në aktivitete shkollore. Diku 38% e prindërve kanë deklaruar se në një masë të kufizuar prindërit nuk kanë kohë për t'u informuar për çështje shkollore, kurse 28% kanë thënë se deri në njëfarë mase, ndërsa te prindërit e anketuar të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara, kjo përqindje është 86%.

Kur prindërit janë pyetur se a dinë prindërit të komunikojnë me mësimdhënësit, 33% e tyre janë përgjegjur aspak, kurse 33% në një masë të kufizuar, ndërsa 51% e prindërve të anketuar të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara kanë thënë se në masë të kufizuar. Në anën tjetër, 34% e prindërve janë dakord deri në një masë të kufizuar se mësimdhënësit nuk janë të interesuar me komunikimin me prindërit, kurse

76% e prindërve të anketuar të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara, janë dakorduar deri në njëfarë mase se mësimdhënësit nuk janë të interesuar në komunikim me prindërit.

Se mësimdhënësit kanë shumë punë për të komunikuar me prindërit, 36% e prindërve mendojnë se kjo është e vërtetë në një masë të kufizuar dhe 28% deri në njëfarë mase pajtohen, kurse 69% e prindërve të anketuar të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara pajtohen deri në njëfarë mase se mësimdhënësit kanë shumë punë për të komunikuar me prindërit. Shumë më pak se gjysma e prindërve (38%) janë pajtuar në masë të kufizuar se shkolla nuk e ka me të vërtetë kapacitetin për të komunikuar me të gjithë prindërit dhe vetëm 21% deri në njëfarë mase. Shumica e prindërve të anketuar (67%) të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara mendojnë në masë të kufizuar se shkolla nuk e ka me të vërtetë kapacitetin për të komunikuar me të gjithë prindërit.

Shumica e prindërve të anketuar (63%) nuk pajtohen aspak se prindërit dhe shkolla janë zakonisht në konflikt. Në zonat urbane është më e lartë (76%) kurse në ato rurale më e ulët (54%), ndërsa në shkollat në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara përqindja e prindërve që nuk pajtohen aspak se prindërit dhe shkolla janë zakonisht në konflikt është 82%.

Më pak se gjysma e prindërve të anketuar (42%) nuk pajtohen aspak se mësimdhënësit nuk dinë se si të komunikojnë me prindërit, mirëpo më shumë se gjysma e prindërve të anketuar (55%) të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara pajtohen deri në njëfarë mase se mësimdhënësit nuk dinë se si të komunikojnë me prindërit.

Gjysma e prindërve të anketuar pajtohen në një masë të madhe apo plotësisht se mësuesi/kujdestari i klasës i trajton prindërit me respekt, ndërsa 82% e prindërve të anketuar të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara, pajtohen deri diku. Gjysma e prindërve të anketuar pajtohen në një masë të madhe apo plotësisht se prindi flet lehtësisht me mësuesin ose kujdestarin e klasës për fëmijën e tij, ndërsa 85% e prindërve të anketuar të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara, pajtohen deri diku me këtë.

Shumica e dërrmuese e prindërve të anketuar thonë se tri ose më shumë se tre herë janë takuar me pedagogun ose psikologun e shkollës, ndërsa të gjithë prindërit e anketuar të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara, thonë se janë takuar vetëm një herë me pedagogun/psikologun e shkollës.

Gjysma e prindërve të anketuar pajtohen plotësisht se të paktën njëri prej anëtarëve të familjes shkon shpesh në objektin e shkollës (përveç se për të marrë fëmijën nga shkolla), ndërsa 76% e prindërve të anketuar të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara, pajtohen në një masë të madhe se të paktën njëri anëtar i familjes shkon shpesh në godinën e shkollës. Më shumë se gjysma pajtohen në një masë të madhe ose plotësisht se nuk flasin me drejtorin sepse ai/ajo është shumë i/e zënë, ndërsa 100% e prindërve të anketuar të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara, pajtohen plotësisht.

2.3 Faktorë parashikues dhe ndërmjetësues

2.3.1 Barrierat ndaj bashkëpunimit shkollë – familje

Gati gjysma e drejtorëve të shkollave (43%) janë të mendimit se në njëfarë mase prindërit nuk janë të interesuar në marrjen pjesë në aktivitete shkollore, e po ashtu gati gjysma e tyre (43%) janë të mendimit se në një masë të kufizuar prindërit nuk kanë kohë për t'u informuar për problemet shkollore. Më pak se gjysma e drejtorëve (43%) nuk pajtohen aspak se prindërit nuk dinë si të komunikojnë me mësimdhënësit, kurse pak më shumë se gjysma e drejtorëve (52%) nuk pajtohen aspak se mësimdhënësit nuk janë të interesuar për të komunikuar me prindërit, e po ashtu pak më shumë se gjysma e drejtorëve (53%) nuk pajtohen aspak se mësimdhënësit kanë shumë punë që nuk i lejon të komunikojnë me prindërit. Më pak se gjysma e drejtorëve (45%) nuk pajtohen aspak se shkolla nuk e ka, në të vërtetë, kapacitetin për të komunikuar me të gjithë prindërit. Shumica dërrmuese e drejtorëve (80%) nuk pajtohen aspak se prindërit dhe shkolla janë zakonisht në konflikt, ndërsa 68% e drejtorëve nuk pajtohen aspak se mësimdhënësit, në të vërtetë, nuk dinë se si të komunikojnë me prindërit.

Tabela 3. Barrierat për komunikimin shkollë-prind

Duke shikuar mbrapa në kohë format e ndryshme të pjesëmarrjes në jetën shkollore, sa dakord do të ishit me fjalitë e mëposhtme?	Aspak	Në një masë të kufizuar	Deri në një farë mase	Në një masë të madhe
1. prindërit nuk janë të interesuar në pjesëmarrjen në aktivitetet shkollore	34%	22%	35%	10%
2. prindërit nuk kanë kohë për t'u informuar për çështjet shkollore		38%	28%	8%
3. prindërit nuk dinë se si të komunikojnë me mësimdhënësit	33%	33%	24%	11%
4. mësimdhënësit nuk janë të interesuar në komunikimin me prindërit	30%	34%	25%	10%
5. mësimdhënësit kanë shumë punë për të komunikuar me prindërit	26%	36%	28%	10%
6. shkolla nuk e ka më të vërtetë kapacitetin për të komunikuar me të gjithë prindërit	35%	38%	21%	7%
7. prindërit dhe shkolla janë zakonisht në konflikt	63%	24%	10%	3%
8. mësimdhënësit nuk dinë se si të komunikojnë me prindërit	42%	30%	19%	10%

2.3.2 Perceptimi mbi hapjen e shkollës

Shumica e dërrmuese e drejtorëve të shkollave (69%) janë të kënaqur në një masë të madhe me përfaqësuesit e prindërve sa i përket pjesëmarrjes së tyre gjatë vitit të kaluar në mbledhjet e Këshillit të Shkollës, kurse 39% janë të kënaqur në njëfarë mase me mendimet e përfaqësuesve të prindërve të dhëna në mbledhjet e Këshillit të Shkollës. Gjysma e drejtorëve të shkollave janë të kënaqur në një masë të madhe me mbështetjen e ofruar nga përfaqësuesit e prindërve për të zgjidhur problemet në lidhje me jetën

shkollore. Po kaq të kënaqur drejtorët janë ndarë edhe me masën në të cilën vendimet e Këshillit të Shkollës i janë komunikuar Këshillit të Prindërve.

Më shumë se gjysma (52%) e drejtorëve të shkollave janë të kënaqur në masë të madhe me pjesëmarrjen e prindërve në mbledhjet e Këshillit të Prindërve, e 34% deri diku të kënaqur, kurse 50% janë të kënaqur në njëfarë mase me mendimet e dhëna në mbledhjet e Këshillit të Prindërve, e 36% në masë të madhe. Më pak se gjysma (43%) e drejtorëve janë të kënaqur në një masë të madhe me mbështetjen që Këshilli i Prindërve ka ofruar për të zgjidhë problemet në lidhje me jetën shkollore, e 36% në njëfarë mase, ndërsa 41 e drejtorëve janë të kënaqur në njëfarë mase me masën në të cilën vendimet e këshillit i janë komunikuar Këshillit të Prindërve, e 34% në masë të madhe.

2.3.3 Romët, Ashkalinjtë dhe Egjiptianët (RAE)

Gati të gjithë prindërit e anketuar të komuniteteve RAE kanë pohuar se është e vështirë për fëmijët e tyre që të jenë në shkollë me fëmijët që nuk i takojnë komunitetit RAE. Shumica absolute 75% e tyre mendojnë se shkolla mund të bëjë më shumë për të ndihmuar fëmijët e këtij komuniteti, kurse gati të gjithë pohojnë se në shkollë nuk ka asnjë punonjës të komunitetit RAE.

Prindërit romë thonë që paragjykimet dhe stereotipet ndaj tyre nga ana e anëtarëve të komuniteteve shumicë janë të dukshme në sistemin e edukimit. Ky qëndrim ndaj romëve nuk është e thënë të jetë i njëjtë edhe ndaj anëtarëve të komuniteteve tjera minoritare. Është interesante se romët trajtohen më mirë në klasat ku mësimi zhvillohet në gjuhët e minoriteteve turke ose boshnjake sesa në klasat ku mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe.


Prindërit romë dhe ashkali kanë qenë më pak të shqetësuar me implementimin e programit të ri dhe përdorimit të metodave të reja të mësimdhënies dhe kanë demonstruar më pak interes për ndryshimet në sistemin e edukimit.

Prindërit e romëve të papërfshirë në këshillat e prindërve mendojnë që drejtorët janë paragjykses dhe për pasojë nuk e nxisin pjesëmarrjen e tyre në jetën shkollore. Ata mendojnë se duhet të jenë më të përfaqësuar në trupat shkollor në mënyrë që të mund të mbrojnë interesat e komunitetit të tyre në shkollë, por ata thonë që mungesa e edukimit të tyre pengon pjesëmarrjen e tyre më aktive.

2.3.4. Përfaqësuesit e prindërve në strukturat e shkollës

Shumica e theksuar e prindërve pajtohen në masë të madhe ose plotësisht se i njohin shumë mirë përfaqësuesit e prindërve në klasën e fëmijës së tyre, mund të flasin lehtë me përfaqësuesin e prindërve lidhur me ndonjë shqetësim që ata kanë për fëmijën e tyre ose klasën dhe se ata i trajtojnë me respekt, ndërsa shumica e prindërve të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara, pajtohen deri-diku me këtë. Shumica e prindërve pajtohen në masë të madhe ose plotësisht se përfaqësuesit e prindërve në shkollë janë aktiv, se i kontaktojnë ata herë pas here dhe se janë efektiv në mbrojtjen e interesave të tyre por, në anën tjetër, shumica e prindërve të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara pajtohen deri diku.

Grafiku 3. Sa pajtohen prindërit se i njohin përfaqësuesit e prindërve në klasën e fëmijës së tyre?



Gjysma e prindërve përfaqësues në Këshillin e Prindërve/Këshillin e Shkollës ose organizma tjerë prind-mësimdhënës kanë mbajtur postet e tyre më shumë se 12 muaj, kurse pjesa tjetër 6-12 muaj ose më pak se 6 muaj. Shumica e prindërve kanë pohuar se kanë arritur të behën anëtarë të Këshillit të Prindërve ose Këshillit të Shkollës pasi ishin zgjedhë nga prindërit tjerë, ndërsa 24% kanë pohuar se një gjë të tillë ua ka kërkuar drejtori i shkollës. Shumica e prindërve përfaqësues thonë se kanë hy në Këshillin e Shkollës/Këshillin e Prindërve për të pas mundësi me e njohtë më mirë shkollën, për të sjellë në vëmendje çështjet që i shqetësojnë të gjithë për të mirën e fëmijëve dhe për të ndryshuar diçka specifike që ka të bëjë me të gjithë fëmijët.

Pjesa tjetër kanë hy në Këshillin e Shkollës/Këshillin e Prindërve për t'u përfshirë, se i ka nxitë dikush që ta bëjnë një gjë të tillë dhe kjo është shumë më e theksuar në zonat urbane sesa ato rurale. Shumica dërmuese e prindërve përfaqësues (84%) që kanë hy në Këshillin e Shkollës/Këshillin e Prindërve sepse prindërit tjerë kanë dëshiruar t'i zgjedhin si përfaqësues.

Më shumë se gjysma e prindërve përfaqësues kanë dhënë mesatarisht kontribut në menaxhimin financiar të shkollës, por edhe në aktivitetet jashtëshkollore (sporte, gjuhë të huaja, arte etj.); kurse shumica dërmuese e tyre kanë dhënë kontribut të njëjtë në organizimin e ngjarjeve shkollore (festime, ekskursionet, etj.), ndikim në vendime, në çështje të shëndetit dhe sigurisë (roja, kryqëzimet rrugore, kamera, drogat, marrëdhëniet me policinë, etj.); në çështje arsimore – përmbajtja e leksioneve, tekstet shkollore, përzgjedhja e mësimdhënësve ose vlerësimi, ngarkesa e nxënësit, detyrat e shtëpisë, etj.); në menaxhimin e përgjithshëm shkolror – turnet, kohët e hapjes, shkrirjet ose mbylljet e klasave ose shkollave, ndryshimi i llojit të shkollës etj. Shumica dërmuese e tyre kanë dhënë kontribut mesatar dhe shumë kontribut në eliminimin e dhunës, përjashtimeve dhe çështjeve dhe procedurave të tjera të disiplinës, etj.

Më pak se gjysma e prindërve të përfaqësuar në Këshillin e Shkollës/Këshillin e Prindërve kanë pohuar se prindërit në përgjithësi kanë ndikim mesatar dhe shumë ndikim në menaxhimin financiar të shkollës (ndërtesat, pajisjet, materiale), kurse kanë ndikim mesatar në aktivitetet jashtëshkollore (sporte shtesë, gjuhë të huaja, arte, etj), ndërsa gjysma e tyre kanë pohuar se prindërit në përgjithësi kanë pak ndikim në organizimin e ngjarjeve shkollore (festime, ekskursionet, etj.) – ndikim në vendime, jo vetëm nëse ju kanë kërkuar ndihmë.

Gati 1/3 e prindërve të përfaqësuar në Këshillin e Shkollës/Këshillin e Prindërve kanë pohuar se prindërit në përgjithësi kanë pak ndikim çështje të shëndetit dhe sigurisë (roja, kryqëzimet rrugore, kamera, drogat, marrëdhëniet me policinë, etj.), ndërsa 30% kanë thënë se prindërit në përgjithësi kanë ndikim mesatar.

Pak më shumë se gjysma e prindërve të përfaqësuar në Këshillin e Shkollës/Këshillin e Prindërve kanë pohuar se prindërit në përgjithësi kanë ndikim mesatar ose shumë ndikim në çështje arsimore – përmbajtja e leksioneve, tekstet shkollore, përzgjedhja e mësimit dhe vlerësimi, ngarkesa e nxënësit, detyrat e shtëpisë, etj., pastaj në parandalimin e dhunës, përjashtimeve dhe çështjeve e procedurave të tjera të disiplinës. Kurse gjysma e prindërve të përfaqësuar në Këshillin e Shkollës/Këshillin e Prindërve kanë pohuar se prindërit në përgjithësi kanë pak ndikim ose aspak ndikim në menaxhimi i përgjithshëm shkollor – turnet, kohët e hapjes, shkrirjet ose mbylljet e klasave ose shkollave, ndryshimi i llojit të shkollës etj.

Shumica e prindërve përfaqësues pajtohen në masë të madhe ose plotësisht se prindërit në përgjithësi besojnë se ata nuk mund të bëjnë shumë; se e bëjnë këtë punë vetëm për hir të fëmijëve të vet; se e bëjnë këtë punë vetëm për t'u dukur; se mund të jenë të nevojshëm kur ata kanë shqetësime për fëmijën e tyre. Pak më shumë se gjysma e prindërve përfaqësues pajtohen në masë të madhe ose plotësisht se prindërit në përgjithësi besojnë se ata mund t'i përfaqësojnë efektivisht dhe i mbështesin në dhënien zë të shqetësimeve të përbashkëta.

Shumica dërrmuese e prindërve përfaqësues në Këshillin e Shkollës/Këshillin e Prindërve pajtohen në masë të madhe ose plotësisht se administrata e shkollës është shumë e interesuar në kontributin e tyre, por, sipas tyre, administrata e shkollës është e interesuar që prindërit t'i mbështesin vetëm idetë e administratës së shkollës. Ata thonë se administrata e shkollës e dëgjon mendimin e tyre, por nuk e merr parasysh atë. Shumica dërrmuese e prindërve përfaqësues pajtohen në masë të madhe ose plotësisht se ata i njohin të gjithë prindërit e klasës; mund të flasin lehtësisht me prindërit në rast se kanë ndonjë shqetësim në lidhje me fëmijën e tyre; janë aktiv si prindër përfaqësues; i kontaktojnë herë pas here prindërit; dhe janë efektiv në përfaqësimin e interesit të prindërve.


2.3.5 Tradicionale vs partneriteti

Shumica dërrmuese e drejtorëve (81%) mendojnë se sigurimi që fëmija është i gëzuar në shkollë është detyrë e shkollës dhe e prindit. Po ashtu, 81%) e drejtorëve mendojnë sigurimi se fëmija është duke ecur mirë në shkollë është detyrë e shkollës dhe e prindit. 88% e drejtorëve rritja e fëmijës në mënyrë që të bëhet një person i mirë është detyrë e shkollës dhe e prindit. Pothuajse 100% e drejtorëve pohojnë se motivimi i fëmijës për të mësuar është po ashtu detyrë e shkollës dhe e prindit bashkë. Më shumë se gjysma e drejtorëve pohojnë se sigurimi se ka mësimdhënie të mirë është detyrë e shkollës dhe prindit. Ndërsa 57% e drejtorëve thonë se sigurimi se ka aktivitete shtesë shkollore siç janë klubet është më shumë detyrë e shkollës sesa e prindit. 65% e drejtorëve të shkollave thonë se sigurimi se fëmija është i sigurt në shkollë është më shumë detyrë e shkollës se e prindit. Shumica absolute e drejtorëve të shkollave pohojnë se të dish se çfarë është më e mirë për fëmijën është detyrë e shkollës dhe e prindit bashkë. Vetëm 12% e drejtorëve të

shkollave mendojnë se ndërhyrje në rast se diçka nuk shkon në rregull në shkollë është më shumë detyrë e shkollës se e prindit.

Në anën tjetër, shumica e prindërve (67%) thonë se sigurimi që fëmija të jetë i gëzuar në shkollë është detyrë e shkollës dhe e prindit bashkë, por edhe sigurimi se fëmija është duke ecur mirë në shkollë. Më pak se gjysma e prindërve të anketuar thonë se rritja e fëmijës në mënyrë që të bëhet një person i mirë është detyrë e shkollës dhe e prindit bashkë. Shumica absolute e prindërve (96%) të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara pohojnë se fëmijëve të tyre nuk u pëlqen vajtja në shkollë. Shumë më pak se gjysma (37%) e prindërve të anketuar thonë se sigurimi se fëmija i bën detyrat e shtëpisë është detyrë e shkollës dhe e prindit bashkë, ndërsa shumica e prindërve (66%) të anketuar thonë se motivimi i fëmijës për të mësuar është detyrë e shkollës dhe e prindit bashkë. Gati gjysma e prindërve (47%) të anketuar thonë se sigurimi se ka mësimdhënie të mirë është detyrë e prindit dhe e shkollës bashkë, ndërsa 92% e prindërve të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara pohojnë se kjo më shumë është detyrë e shkollës sesa e prindit.

Grafiku 4. Sigurimi që fëmija është i gëzuar në shkollë



Gjysma e drejtorëve të shkollave janë të mendimit se frekuentimi më i madh do të lehtësonte dhe përmirësonte bashkëpunimin shkollë-prind; vetëm 12% e drejtorëve e shohin bashkëpunimin më të mirë si një lehtësim për përmirësimin e bashkëpunimit shkollë-prind; ndërsa 25% e drejtorëve e shohin partneritetin mes shkollës dhe prindit si një lehtësim për përmirësimin e bashkëpunimit shkollë-prind; dhe 39% e drejtorëve mendojnë se një angazhim më i madh mund të çojë në përmirësimin e bashkëpunimit shkollë-prind.

Kurse, 43% e prindërve të anketuar thonë se sigurimi se ka aktivitete shtesë shkollore siç janë klubet është detyrë e prindit dhe e shkollës bashkë, ndërsa 95% e prindërve të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara pohojnë se kjo më shumë është detyrë e shkollës sesa e prindit. 46% e prindërve të anketuar thonë se sigurimi se fëmija është i sigurt në shkollë është detyrë e prindit dhe e shkollës bashkë, ndërsa 86% e prindërve të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara pohojnë se kjo më shumë është detyrë e shkollës sesa e prindit. 58% e prindërve të anketuar thonë se të dish se çfarë është më e mirë për fëmijën është detyrë e prindit dhe e shkollës bashkë, ndërsa 45% e prindërve të shkollave në zonat me numër të

madh të grupeve të përjashtuara pohojnë se kjo më shumë është detyrë e shkollës sesa e prindit. 57% e prindërve të anketuar thonë se ndërhyrja në rast se diçka nuk shkon në rregull në shkollë është detyrë e prindit dhe e shkollës bashkë, ndërsa të gjithë prindërit e shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara pohojnë se kjo më shumë është detyrë e shkollës sesa e prindit.

2.4. Rezultatet e perceptuara të përfshirjes së prindërve

Më shumë se gjysma e prindërve pajtohen në masë të madhe ose plotësisht se fëmijët janë të gëzuar në shkollë, ndërsa 98% e prindërve të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara pohojnë se pajtohen deri diku me këtë. Po ashtu, më shumë se gjysma e prindërve pajtohen në masë të madhe ose plotësisht se fëmijët janë duke ecur mirë në punën e tyre shkollore, kurse 98% e prindërve të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara pohojnë se pajtohen deri diku me këtë. Shumica e prindërve pajtohen se fëmijët marrin kënaqësi nga aspektet e tjera shkollore (përveçse punës shkollore).

Se fëmijët janë duke arritur me të mirën e aftësive të tyre pajtohen në masë të madhe ose plotësisht më shumë se gjysma e prindërve, ndërsa në shkollat në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara gati të gjithë prindërit pohojnë se pajtohen deri diku me këtë.

Shumica e prindërve pajtohen në masë të madhe ose plotësisht se ata mund të marrin çdo ndihmë për të cilën kanë nevojë nëse fëmija ka ndonjë problem të ndryshëm nga mësimi shkollor, kurse të gjithë prindërit e shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara pajtohen me këtë deri diku.

Me konstatimin se shkolla është një vend i sigurt për fëmijën e tyre janë pajtuar në masë të madhe ose plotësisht më shumë se gjysma e prindërve, ndërsa 100% e prindërve të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara pohojnë se pajtohen deri diku me këtë. Kjo përqindje në vendet urbane (55%) është dukshëm më e lartë se sa në vendet rurale (29%).

Më shumë se gjysma e prindërve pajtohen në masë të madhe ose plotësisht se mësimdhënia është e një cilësie të lartë, ndërsa 100% e prindërve të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara pohojnë se pajtohen deri diku me këtë. Kjo është më e theksuar në zonat urbane (56%) sesa në ato rurale (22%).

Kur bëhet fjalë për trajtimin me respekt të prindërve nga shkolla, më shumë se gjysma e prindërve janë pajtuar në masë të madhe ose plotësisht. Shumica dërrmuese e tyre janë të kënaqur në masë të madhe ose plotësisht me cilësinë dhe sasinë e informacionit nga shkolla, ndërsa 100% e prindërve të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara pohojnë se pajtohen deri diku me këtë.

Tabela 4. Rezultatet e perceptuara të përfshirjes së prindërve

Sa dakord jeni me fjalitë e mëposhtme?	Nuk pajtohem aspak	Pajtohem deri diku	Pajtohem në masë të madhe	Pajtohem plotësisht
1 sigurimin se fëmijët janë të gëzuar në shkollë		15%	46%	39%
2 sigurimin se fëmija është duke ecur mirë në punën e tij/saj shkollore		18%	46%	35%
3 Fëmija është duke arritur me të mirën e aftësive të tij/saj		24%	41%	35%
4 Unë mund të marr çdo ndihmë për të cilën kam nevojë nëse fëmija ka ndonjë problem të ndryshëm nga mësimi shkollor		30%	34%	36%
5 Shkolla ime është një vend i sigurt për fëmijën		22%	37%	41%
6 Mësimdhënia është e një cilësie të lartë		20%	42%	38%
7 Mua më/ne na trajtojnë me respekt nga shkolla		14%	44%	42%

3. Përfundimet

- Përderisa prindërit e zakonshëm dhe ata pjesëmarrës janë ftuar në mbledhje dy deri tri herë (43%) dhe më shumë se tri herë (33%), te prindërit e shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara, 76% e prindërve janë ftuar vetëm një herë.
- Më shumë se gjysma e prindërve të zakonshëm nuk kanë marrë kurrë informacion nga shkolla se si të ndihmohet fëmija për të mësuar, për shkollën, rregullat dhe përmbajtjen e lëndëve, e numri i atyre që pranojnë informacione të këtilla është dyfish më i lartë në zonat urbane.
- Shkollat përgjithësisht nuk u dërgojnë prindërve informacione të shkruara përkitazi me çështjet si shëndeti, droga, dhuna..., e edhe kur një gjë e tillë ndodhë, informacionet u dërgohen më shumë prindërve të përfshirë në struktura të shkollës.
- Gati gjysma e prindërve gjatë të vitit të kaluar nuk kanë marrë informacione të shkruara nga shkolla për mbarëvajtjen e fëmijës – vlerësim i shkruar, raporte notash, raporte përfundimtare, dhe/ose raporte të ngjashme, pavarësisht nëse ato raporte janë dhënë në ndonjë takim klase, janë dërguar me anë të fëmijës, janë dërguar në shtëpi, apo në një mënyrë tjetër të ngjashme. Sipas tyre, këto raporte të shumtën e herave janë lexuar nga dikush në shtëpi dhe shumica thonë se shkolla duhet t'ua dërgojë prindërve raportet e këtilla.
- Shumica e prindërve pohojnë se është detyrë e shkollës që t'u kërkoj familjeve që t'i ndihmojnë fëmijët në detyrat e shtëpisë. Sipas tyre të paktën dikush nga familja është i aftë dhe kompetent për ta bërë këtë gjë. Ata thonë se është detyrë e familjes që t'u ndihmoj fëmijëve të tyre dhe kjo i ndihmon fëmijët e tyre.
- Në shumicën e rasteve fëmijët ndihmohen nga nëna rreth kryerjes së detyrave të shtëpisë, kurse prindërit e të anketuarve të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara, në të gjitha rastet ndihmohen nga nënat. Këtu më shumë janë të përfshirë prindërit që janë pjesë e strukturave të shkollës. Shumica e drejtorëve të shkollave thonë se shkolla nuk i ka furnizuar prindërit me udhëzime se si të ndihmojnë në mënyrë efektive fëmijët në lidhje me detyrat e shtëpisë, por sipas tyre, prindërit nuk e kanë kërkuar një gjë të tillë.
- Pak më shumë se gjysma e prindërve (52%), kryesisht prindër të zakonshëm dhe prindër të përfshirë në strukturat e shkollës, pohojnë se gjatë vitit të kaluar, shkolla asnjëherë nuk i ka ftuar për të ofruar ndihmë me aktivitete sportive, sociale dhe kulturore – teatër, koncerte, ekskursionet, etj., ndërsa 75% e prindërve të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara thonë se një gjë e tillë u është kërkuar të paktën një herë nga ana e shkollës. Prindërit që kanë marrë këtë lloj ftese nga ana e shkollës kanë dhënë të paktën një herë ndihmën e tyre për këtë çështje. Pak më shumë se gjysma kanë thënë se shkolla duhet ta kërkojë një gjë të tillë nga prindërit.
- Shumica dërrmuese e prindërve dhe të gjithë prindërit e shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara, kanë pohuar se gjatë vitit të kaluar shkolla

asnjëherë nuk u ka kërkuar ndihmë me orët mësimore – tregimi i një historie, biseda mbi punën, luajtje e një instrumenti, asistencë për mësimdhënësit. Kjo është dukshëm më e theksuar në zonat rurale (88%). Gjysma e atyre që e kanë marrë këtë lloj ftese kanë ofruar ndihmën e tyre çdo herë dhe kjo është shumë më e theksuar në zonat urbane. Po ashtu, gjysma kanë thënë se shkolla duhet ta kërkojë një gjë të tillë nga prindërit.

- Më shumë se gjysma (68%) e familjeve të zakonshme (përqindja në zonat rurale është dukshëm më e lartë) nuk janë ftuar asnjëherë që të ofrojnë ndihmën e tyre në shërbimet shkollore si biblioteka, vendi i lojërave dhe dhoma e ngrënies dhe po aq është përqindja e atyre që janë të mendimit se shkolla duhet ta kërkojë një gjë të tillë. Më pak se gjysma (43%) e atyre që u është kërkuar një ndihmë e tillë, kanë dhënë ndihmën e tyre të paktën një herë dhe, sipas tyre, shkolla duhet t'ua kërkojë prindërve një gjë të tillë. Më shumë se gjysma e prindërve (58%) kanë pohuar se në familjet e tyre të paktën një person është i aftë dhe kompetent për të ndihmuar në ndonjë mënyrë rreth ndihmave vullnetare të përmendura më lart dhe pak më pak se gjysma e tyre (48%) mendojnë se të paktën dikush prej familjes e ka për detyrim që të ofrojë këtë ndihmë. Sipas tyre me dhënien e kësaj ndihme vullnetare për shkollën ndihmohen edhe fëmijët e tyre.
- Gati gjysma e prindërve të zakonshëm kanë qenë të ftuar 3 ose më shumë se 3 herë nga shkolla për të ndihmuar në mirëmbajtjen ose përmirësimin e infrastrukturës së shkollës si pastrimin, lysterjen, ndërtimin, etj. Mbi gjysma e tyre kanë dhënë këtë ndihmë çdo herë ose të shumtën e herave dhe kjo përqindje është dyfish më e madhe në zonat urbane.
- Pak më shumë se gjysma e prindërve kanë thënë se shkolla nuk i ka ftuar kurrë për të dhënë ndihmë në mirëmbajtjen ose përmirësimin e infrastrukturës shkollore si pastrimi, ndërtimi, lysterja, ndërsa 92% e prindërve të anketuar të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara, pohojnë se shkolla nuk i ka ftuar ndonjëherë për ta dhënë këtë ndihmë. Gati gjysma kanë thënë se e kanë dhënë këtë ndihmë çdo herë dhe gati gjysma kanë thënë se e kanë dhënë këtë ndihmë një herë dhe se shkolla duhet ta kërkojë një gjë të tillë. Shumica e dërmuese e drejtorëve mendojnë se shkolla duhet t'ua kërkojë prindërve të zakonshëm një ndihmë të tillë.
- Pothuajse gjysma e prindërve të zakonshëm nuk kanë qenë të ftuar asnjëherë nga shkolla për të ndihmuar me aktivitete sportive, sociale dhe kulturore – teatër, koncerte, ekskursionet, etj. Në zonat rurale 62% e prindërve të zakonshëm nuk kanë qenë të ftuar asnjëherë nga shkolla për të ndihmuar me aktivitete të tilla. Shumica e drejtorëve është e mendimit se shkolla duhet t'i ftojë familjet në këto aktivitete.
- Shumicës së prindërve dhe të gjithë prindërve të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara nuk u është kërkuar mendim për menaxhimin financiar të shkollës e as për aktivitetet shkollore. Ndërsa, kur është në pyetje organizimi i ngjarjeve shkollore si festime e ekskursionet prindërit thonë se është kërkuar mendimi i tyre.
- Më shumë se gjysma e prindërve të zakonshëm, por edhe të përfshirë në strukturën shkollore, thonë se nuk u është kërkuar asnjëherë mendim për shëndetin dhe çështjet e

sigurisë (rojet mbikëqyrëse, kalimi i rrugës, kamerat, droga, raporti me policinë, etj.), kurse 96% e prindërve të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara kanë thënë se shkolla nuk u ka kërkuar mendim për këto çështje.

- Shumica dërrmuese e prindërve (75%), kryesisht prindër të zakonshëm, por edhe të përfshirë në strukturat shkollore, kanë deklaruar se gjatë vitit të kaluar shkolla asnjëherë nuk i ka pyetur lidhur me menaxhimin e përgjithshëm të shkollës – turnet, oraret e hapjes, shkrirja ose mbyllja e hapja në shkollë, ndryshimi i vendndodhjes, ndryshimi i llojit të shkollës, etj. Kjo shifër në zonat rurale është dukshëm më e lartë se sa në ato urbane. Ndërsa, 100% e prindërve të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara kanë thënë se shkolla nuk i ka pyetur kurrë për çështjet e sipërpërmendura.
- Shumica e prindërve (65%) kanë thënë se gjatë vitit të kaluar shkolla asnjëherë nuk u ka kërkuar mendim për çështjet arsimore – përmbajtja e leksioneve, tekstet mësimore, përzgjedhja ose vlerësimi i mësimdhënësve, ngarkesa mësimore e nxënësit dhe detyrat e shtëpisë. Kjo përqindje në zonat rurale është dukshëm më e lartë. Ndërsa të gjithë prindërit e shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara kanë thënë se shkolla nuk u ka kërkuar asnjëherë mendim për çështjet e lartpërmendura.
- 41% e prindërve, shumica e tyre prindër të zakonshëm, kanë pohuar se gjatë vitit të kaluar, shkolla nuk u ka kërkuar asnjëherë mendim për dhunën ndaj nxënësit, përjashtimet dhe çështje e procedura të tjera që kanë të bëjnë me disiplinën e nxënësit. Kjo përqindje është dukshëm më e thellë në zonat rurale (49%) sesa në ato urbane (30%).
- Mirëpo, shumica dërrmuese e prindërve (82 %) thonë se asnjëherë nuk janë munduar të ndikojnë vetë për të bërë ankesa për një notë, ankesa për ndonjë fëmijë tjetër, etj., ndërsa 100% e prindërve të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara kanë thënë se nuk janë munduar ndonjëherë të ndikojnë personalisht për të bërë ankesat e mësipërme.
- Shumica dërrmuese e prindërve (88%) thonë se nuk janë munduar asnjëherë të ndikojnë në diçka së bashku me prindërit e tjerë, ndërsa prindërit e shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara, kanë thënë se nuk janë munduar asnjëherë për ta bërë një gjë të tillë.
- Sipas gjetjeve rezulton se 61% e prindërve të zakonshëm japin mendimet/qëndrimet e tyre nëpërmjet takimeve individuale të prindërve me mësimdhënësin/pedagogun/drejtorin e shkollës. Ndërsa, përqindja e prindërve që japin mendimet/qëndrimet e tyre në mbledhje të klasës ose përmes përfaqësuesve në organizmat e shkollës është dukshëm më e vogël.
- Shumica dërrmuese e prindërve dhe 100% e prindërve të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara, kanë deklaruar se gjatë tri viteve të kaluara askush nga familjet e tyre nuk e ka mbajtur postin e përfaqësuesit të prindërve, postin e anëtarit të Këshillit të Shkollës apo në ndonjë organizim tjetër të ngjashëm. Më shumë se gjysma kanë deklaruar se ata apo dikush nga familja janë të aftë për të

mbajtur pozita në këto organizime. Më shumë se gjysma mendojnë se kjo do të ndihmonte fëmijët e tyre.

- Prindërit kanë deklaruar se një pjesë e prindërve nuk kanë kohë dhe nuk janë të interesuar për të marrë pjesë në aktivitetet shkollore, ndërsa te prindërit e grupeve të përjashtuara kjo përqindje është dukshëm më e lartë.
- Shumica e prindërve të anketuar të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara, janë dakorduar deri në njëfarë mase se mësimdhënësit nuk janë të interesuar në komunikim me prindërit.
- Prindërit janë të mendimit se mësimdhënësit kanë shumë punë për të komunikuar me prindërit dhe se shkolla nuk e ka me të vërtetë kapacitetin për të komunikuar me të gjithë prindërit. Në zonat rurale kjo përqindje është më e theksuar.
- Prindërit mendojnë se mësuesi/kujdestari i klasës i trajton prindërit me respekt dhe se prindi flet lehtësisht me mësuesin ose kujdestarin e klasës për fëmijën e tij.
- Gati të gjithë prindërit e anketuar të komunitetit RAE kanë pohuar se është e vështirë për fëmijët e tyre që të jenë në shkollë me fëmijët që nuk i takojnë komunitetit RAE. 75% e tyre mendojnë se shkolla mund të bëjë më shumë për të ndihmuar fëmijët e këtij komuniteti. 96% e tyre pohojnë se në shkollë nuk ka asnjë punonjës të komunitetit RAE.
- Shumica e theksuar e prindërve pajtohen në masë të madhe ose plotësisht se i njohin shumë mirë përfaqësuesit e prindërve në klasën e fëmijës së tyre, se janë aktiv, se mund të flasin lehtë me përfaqësuesin e prindërve lidhur me ndonjë shqetësim që ata kanë për fëmijën e tyre ose klasën dhe se ata i trajtojnë me respekt, ndërsa shumica e prindërve të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara, pajtohen deri-diku me këtë.
- Shumica e prindërve thonë se sigurimi që fëmija të jetë i gëzuar në shkollë është detyrë e shkollës dhe e prindit bashkë, por edhe sigurimi se fëmija është duke ecur mirë në shkollë. Më pak se gjysma e prindërve thonë se rritja e fëmijës në mënyrë që të bëhet një person i mirë është detyrë e shkollës dhe e prindit bashkë.
- Shumica absolute e prindërve të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara pohojnë se fëmijëve të tyre nuk u pëlqen vajtja në shkollë.
- Shumë më pak se gjysma e prindërve të anketuar thonë se sigurimi se fëmija i bën detyrat e shtëpisë është detyrë e shkollës dhe e prindit bashkë, ndërsa shumica e prindërve thonë se motivimi i fëmijës për të mësuar është detyrë e shkollës dhe e prindit bashkë. Gati gjysma e prindërve (47%) thonë se sigurimi se ka mësimdhënie të mirë është detyrë e prindit dhe e shkollës bashkë, ndërsa 92% e prindërve të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara pohojnë se kjo më shumë është detyrë e shkollës sesa e prindit.
- Gati gjysma e prindërve thonë se sigurimi se ka aktivitete shitesë shkollore siç janë klubet është detyrë e prindit dhe e shkollës bashkë, ndërsa shumica absolute e prindërve të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara pohojnë se kjo më shumë është detyrë e shkollës sesa e prindit.

- Më shumë se gjysma e prindërve pajtohen në masë të madhe ose plotësisht se fëmijët janë të gëzuar në shkollë, janë duke ecur mirë në punën e tyre shkollore, se fëmijët marrin kënaqësi nga aspektet e tjera shkollore (përveçse punës shkollore), se fëmijët janë duke arritur me të mirën e aftësive të tyre, se ata mund të marrin çdo ndihmë për të cilën kanë nevojë nëse fëmija ka ndonjë problem të ndryshëm nga mësimi shkollor, se shkolla është një vend i sigurt për fëmijën e tyre, se mësimdhënia është e një cilësie të lartë, se trajtohen me respekt nga shkolla, ndërsa shumica e prindërve të shkollave në zonat me numër të madh të grupeve të përjashtuara pohojnë se pajtohen deri diku me këtë, e kjo përqindje është më e lartë në zonat urbane sesa ato rurale.

4. Rekomandimet

Në bazë të përfundimeve të dhëna më sipër, rekomandimet janë ndarë në tri kategori:

Për shkollat:

5. Shkollat duhet të zhvillojnë procedura për takime me prindër që përcaktojnë dinamikën, përgatitjen dhe rrjedhën e takimeve të tilla. Duhet të praktikohen si takime grupore/tematike, ashtu edhe takime individuale me prindër. Një kërkim veprues i bërë në 4 shkolla të Kosovës ka treguar se procedurat e tilla janë shumë të dobishme për avancimin e komunikimit me prindër. Është e nevojshme që edhe mësimdhënësit të aftësohen për menaxhimin e takimeve të tipeve të ndryshme dhe vënien e tyre në funksion të avancimit të mësimdhënies dhe nxënies në shkollë
6. Përveç takimeve me prindër, shkollat duhet të organizojnë informimin e rregullt të prindërve edhe përmes medimeve të tjera, si mesazhet që përcillen përmes nxënësve, e-maili, etj, sidomos për çështjet që kërkojnë vëmendje të menjëhershme të prindit.
7. Shkollat duhet të angazhohen për vetëdijesimin e prindërve për rolin e tyre në shkollë, si dhe për aftësimin e tyre për ta ushtruar një rol të tillë. Po ashtu, prindërit duhet të vetëdijesohen se rolin e tyre në raport me fëmijën nuk e ushtrojnë vetëm me kërkesën e shkollës, por e bëjnë vazhdimisht, sepse është në dobi të fëmijës. Progres mund të arrihet nëse takimet me prindër strukturohen në atë mënyrë që të përcillen mesazhe mobilizuese tek prindërit.
8. Prindërit kanë nevojë për një përkrahje më të madhe nga ana e shkollës për të qenë në gjendje t'u ndihmojnë fëmijëve të tyre për përmirësimin e rezultateve të të nxënësve, sepse, edhe atëherë kur janë të gatshëm ta bëjnë një gjë të tillë, ju mungojnë njohuritë dhe shkathtësitë e nevojshme. Duke avancuar në komunikimin e tyre me prindër, shkollat duhet të mendojnë edhe për modalitete të ofrimit të ndihmës për prindër, gjë që mund të realizohet përmes sesioneve të informimit.

Për sektorin qeveritar:

1. Meqë janë në proces ndryshimet e legjislacionit në arsimin parauniversitar duhet t'i kushtohet më shumë kujdes demokratizimit të qeverisjes në shkolla, që bën të mundur një shkallë më të lartë të përfshirjes së prindërve në këtë proces. Nga ana tjetër, duhet ofruar një përkrahje më të madhe për Këshillin e Prindërve të Arsimit të Kosovës, i cili është rithemeluar në vitin 2009 pas disa vitesh mosaktiviteti.
2. Të vazhdohet me decentralizimin financiar deri në nivel të shkollës, duke shtuar kështu përgjegjësinë e shkollës për menaxhimin e financave të veta dhe duke krijuar mundësi shtesë për kontribute financiare të prindërve në shkollë.
3. Të inkurajohen shkollat për të përmirësuar komunikimin me prindër, duke përkrahur aktivitetet e institucioneve profesionale qeveritare dhe joqeveritare për hartimin e doracakëve dhe udhëzuesve që ndihmojnë këtë proces.

Për sektorin joqeveritar:

1. Të punohet në vetëdijesimin e prindërve për rolin e tyre në shkollë dhe në nivele të tjera. Në këtë drejtim, të zhvillohen aktivitete vetëdijesimi, si në nivel të shkollës, ashtu edhe në nivel të komunës, të rajonit, apo të vendit.
2. Të punohet për ndërtimin e kapacitetit të shoqatave të prindërve në të gjitha nivelet, në mënyrë që të ndihmohet rritja e ndikimit të prindërve në jetën e shkollës. Këto shoqata duhet të aftësohen për të punuar me prindërit dhe me përfaqësuesit e tyre në shkolla në kuptim të ndërtimit të kapacitetit për të ushtruar më mirë rolin dhe përgjegjësinë e tyre.
3. Të promovohen shembuj të mirë të përfshirjes së prindërve në jetën e shkollës, duke krijuar kështu mundësi për të përfituar prej tyre.

Bibliografia

1. Rregullorja nr 2002/19 lidhur me shpalljen e Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, 31 tetor 2002.
2. Udhëzimi Administrativ i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, 28 janar 2003.
3. Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, 26 mars 2007.
4. Ligji për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nr. 03/ L-068, 21 maj 2008.
5. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 15 qershor 2008.